



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 34/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.01.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomik “6D Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-34050-08-21-2019, me objekt: “Rikonstruksioni i tarracës së paraklinikut dhe bodrumeve të dekanatit të FM-së”, me fond limit 16.399.882 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.”

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertave së operatorit ekonomik “2N” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “6D Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k.
Rruga “Jusuf Vrioni”, Pallati “Alsion”, Shk.2, Kati 2, Njësia Nr.5,
Tiranë

“Colombo” sh.p.k.
Lagja “Kryengritja e Fierit”, Rruga “Vangjel Rrushku”, Fier

Autoriteti Kontraktor: Universiteti Mjekësisë, Tiranë
Rruga “Dibrës”, Nr. 371, 1005, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.08.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-34050-08-21-2019, me objekt: “Rikonstruksioni i tarracës së paraklinikut dhe bodrumeve të dekanatit të

FM-së”, me fond limit 16.399.882 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.

II.2. Në datën 30.09.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 22.11.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--|-----------------------------------|
| 1. BOE “6D - Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k. | 12.283.886 lekë, skualifikuar |
| 2. “Ante - Group” sh.p.k. | 12.501.779,50 lekë, skualifikuar |
| 3. “2N” sh.p.k. | 12.789.616 lekë, kualifikuar |
| 4. “Colombo” sh.p.k. | 13.081.250 lekë, skualifikuar |
| 5. “Kacdedja” sh.p.k. | 13.111.837 lekë, skualifikuar |
| 6. “Leon Konstruksion” sh.p.k. | 13.117.888,42 lekë, kualifikuar |
| 7. “Viante Konstruksion” sh.p.k. | 13.119.806 lekë, kualifikuar |
| 8. BOE “Jogi” sh.p.k. & “Spektri” sh.p.k. | 13.307.228 lekë, kualifikuar |
| 9. BOE “Senka” sh.p.k. & “Mane/s” sh.p.k. | 13.674.277,20 lekë, kualifikuar |
| 10. BOE “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. & “BM Konstruksion” sh.p.k. | 13.757.308,30 lekë, kualifikuar |
| 11. “Alb Tiefbau” sh.p.k. | 14.431.454 lekë, kualifikuar |
| 12. “Ad - Star” sh.p.k. | 15.252.229 lekë, kualifikuar |
| 13. “Aurora Konstruksion” sh.p.k. | 15.496.484 lekë, kualifikuar |
| 14. “Elda - VL” sh.p.k. | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 17.12.2019 ka kryer ri-vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- | | |
|--|----------------------------------|
| 1. BOE “6D - Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k. | 12.283.886 lekë, skualifikuar |
| 2. “Ante - Group” sh.p.k. | 12.501.779,50 lekë, skualifikuar |
| 3. “2N” sh.p.k. | 12.789.616 lekë, kualifikuar |
| 4. “Colombo” sh.p.k. | 13.081.250 lekë, kualifikuar |
| 5. “Kacdedja” sh.p.k. | 13.111.837 lekë, skualifikuar |
| 6. “Leon Konstruksion” sh.p.k. | 13.117.888,42 lekë, kualifikuar |
| 7. “Viante Konstruksion” sh.p.k. | 13.119.806 lekë, kualifikuar |
| 8. BOE “Jogi” sh.p.k. & “Spektri” sh.p.k. | 13.307.228 lekë, kualifikuar |
| 9. BOE “Senka” sh.p.k. & “Mane/s” sh.p.k. | 13.674.277,20 lekë, kualifikuar |
| 10. BOE “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. & “BM Konstruksion” sh.p.k. | 13.757.308,30 lekë, kualifikuar |

11. "Alb Tiefbau" sh.p.k.	14.431.454 lekë, kualifikuar
12. "Ad - Star" sh.p.k.	15.252.229 lekë, kualifikuar
13. "Aurora Konstruksion" sh.p.k.	15.496.484 lekë, kualifikuar
14. "Elda - VL" sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.5. Në datën 22.11.2019 bashkimi i operatorëve ekonomikë "6D - Plan" sh.p.k. & "2Z Konstruksion" sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

- *Operatori ekonomik 6D Plan nuk ka licencën e kërkuar sipas dokumentave Standarte të Tenderit përse i përket licencës së restoratorit, konkretisht pika 2.3.3 kapaciteti teknik, shtojca 12 kriteret e vecanta të kualifikimit.*
- *Operatori ekonomik "6D Plan" nuk ka plotësuar pikën 2.3.8 kriteret e vecanta të kualifikimit shtojca 12 pasi ka paraqitur diplome, librezë pune, kontratën por nuk ka paraqitur urdhërin e mjekut të kërkuara në Dokumentet Standarte të tenderit.*
- *Analiza e cmimeve mungojnë artikujt është e paplotë ka vetëm 16 emërtime.*

II.5.1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "6D - Plan" sh.p.k. & "2Z Konstruksion" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në datë 02.12.2019 duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit, me pretendimet si më poshtë vijon:

[...] Nepermjet kesaj ankese prane autoritetit kontraktor Universiteti i Mjekesise Tirane": B.O.E. "6D PLAN" sh.p.k. & "2Z KONSTRUKSION" shpk, kundërshton s'kualifikimin si te pa bazuar ne LPP, Rregullat e prolmrimit publik dhe ne fakte, per shkaqet dhe arsyet e meposhtme:

S'kualifikimi i operatorit ekonomike B.O.E. "6D-PLAN" sh.p.k. & 2Z KONSTRUKSION" shpk. Nuk qendron dhe është i pa mbështetur ne fakte per arsye se:

Se pari: prej AK- Universiteti i Mjekesise Tirane ne prokurimin publik ne fjale, ne DST dhe ne sistemin elektronik ne faqen app.gov.al është kerkuar:

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me:

a) Me license "Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës" për shoqëri ndërtimi, sipas kategorisë "Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të", lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

ose

b) Duhet të ketë të punësuar ekspert që zotëron licensë profesionale "Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës", sipas kategorisë "Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të", lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Sa me siper kemi paraqitur dokumentacionin ku B.O.E. "6D-PLAN" sh.p.k., & 2Z KONSTRUKSION shpk prezanton si me poshte:

Ekspertin: Fotjon Qirinxhi

Eksperti i Lartepërmendur ploteson kriterin e kerkuar "ekspert qe zoteron license profesionale "Zbatim per punimet e restaurimit ne monumentet e arkitektures", sipas kategorise "Zbatim ne restaurimin e ndertimeve civile monumenteve te kategorise se I-re dhe te II-te", leshuar nga

Ministria e Kultures, Keshilli Kombetar i Restaurimit” pasi prej mbi 3 vjet, nuk jepen Licence me objektin e mesiper, prej organit leshues.

Eksperti yne, ka mbi 7 vjet nga diplomimi dhe i ploteson kriterin per licencim pasi pervec Diplomes si arkitekt gezon dhe Titullin/Graden "Master Profesional ne "RESTAURIM MONUMETESH KULTURE" prej me shume se dy vitesh.

Gjithashtu ne si shoqeri ofertuese kemi paraqitur kerkese prane "Institutit te Monumenteve te Kultures" per interpretim dhe qartesis mbi kriterin e kerkuar, preventivin e punimeve dhe objektin "Rikonstruksioni I tarraces se paraklinikut dhc bodrumeve te dekanatit tc FM-se"

Ne Pergjigjen c dhene prej Autoritetit "Institutit te Monumenteve te Kultures", na eshte interpretuar se Licenca e zbatimit qe kerkohet ne DST, nevojitet vetem ne rastet kur ka "nderhyrje restauruese ne pamjen e jashtme te monumentit".

Ne rastin konkret kemi nderhyrje ne Tarace dhe Bodrume.

Gjithashtu edhe vet Projektuesi i nderhyrjes ne fjale nuk e Gezoni Licencen e kerkuar ne projektim, dhe kerkohet ne zbatim.

Sa mesiper mendojme se Autoriteti Kontraktor "Universiteti Mjekesise, Tirane" ka skualifikuar ne menyre te pa drejte : B.O.E. "6D-PLAN" sh.p.k, & 2Z KONSTRUKSION" shpk.

Se dyti: mbi Kriterin : 2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete pjese te stafit te punesuar, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, Urdher mjeku, diplome, libreze pune dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten 6 (gjashte) muajt e fundit, 1 (nje) mjek te pergjithshem. Ne rastin e bashkimit te Operatoreve ekonomike, secili prej Operatoreve duhet te kete pjese te stafit te tij 1 (nje) mjek te pergjithshem. (Ne mbeshetete te VKM Nr. 692 date 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, date 06.11.2003 "Per masat e vecanta te sigurimit dhe mbrojtjes se shendetit ne pune", Neni 12/1 Operatorit ekonomik pjesmarres qe kane te punesuar me pak se 15 (pesembdhjete) punonjes nuk kane detyrim ligjor plotesimin e kerkeses se mesiperme.)

Sgarojme se: Per plotesimin e Kriterit te mesiper B.O.E. "6D-PLAN" sh.p.k. & 2Z KONSTRUKSION" shpk, ka paraqitur Mjekun "Pavlina T. Me Licence Nr.121., date 26.10.2015.

Sa mesiper eshte pa kuptim, si dhe e padrejte, skalifikimi per mungese te mjekut te licencuar, pasi ne SPE, eshte ngarkuar dokumentacioni i kerkuar per plotesimin e kriterit te vene, per pasjen ne dispozicion te mjekut gjate zhvillimit te punimeve ne zbatimin e objektit "Rikonstruksioni i tarraces se paraklinikut dhe bodrumeve te dekanatit te FM-se",

Duke besuar se Nje Mjek eshte i mjaftueshem per realizimin me sukses te kesaj kontrate kerkojme qe te kualifikohemi ne procedure.

Se treti: KVO shprehet se mungon "analiza e cmimeve mungojne artikujt eshle e paplote ka vetem 16 emertime".

Sqarojme se ky kriter nuk mund te jete skualifikues pasi, oferta behet me Preventiv dhe cmime per njesi, dhe nuk ofertohet me analize cmimesh. Edhe nese AK do te kishte pikpyetje mbi nje cmim te caktuar mund te kerkonte analize cmimesh apo sqarime mbi kostot e cmimit perkates, por kuresesi te Refuzonte nje Oferte Fituese.

AK ne rastin konkret, duhet te marre nje vendim te mbeshetur ligjerisht, te argumentuar, si dhe me kryesorja ne interes te vet Autoritetit dhe jo te s'kualifikoje, pa te drejte nje operator ekonomik me oferte fituese: 14.740.663 Leke dhe te shpalle fitues nje tjetere me vlere: 15.347.539, me mbi 606.876 leke me shume, ose ne Perqindje 4 % , me Teper, dem ekonomik, shkaktuar interesave te institucionit prej KVO-se, ky fakt ne kundershtrim dhe me LPP - NENI 1 PIKA 2/b.

Per kete arsye ky s'kualifikim, mendojme qe nuk qendron teknkisht, ligjerisht dhe ekonomikisht. Kriteret per kualifikim vendosen qe ti sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te rcalizimit me sukses te kontrates.

Sa me siper, përfundimisht kërkohet kualifikimin e operatorit ekonomik BOE "6D Plan" sh.p.k. & "2Z Konstruksion" sh.p.k. dhe shpalljen fitues per prokurimin.

II.5.2. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes, si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 06.12.2019, me anë të shkresës nr.1422/43 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes duke e refuzuar atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor argumenton:

"[...] Nga permbajtja e ankeses rezulton se ankuesi nuk eshte dakort me klasifikimin perfundimtar te ofertave dhe skualifikimin e ofertes se tij, duke ngritur pretendimet si me poshte:

1. Lidhur me arsyen e pare te skualifikimit ankuesi pretendon se ka paraqitur dokumentacionin e ekspertit Fotjon Qirinxi, ku ne dokumentacionin e tij plotesohet kriteri ekspert qe zoteron license profesionale "Zbatim per punimet e restaurimit ne monumentet e akritektures" sipas kategorise "Zbatim ne restaurimin e ndertimeve civile monumenteve te kategorise se I-re dhe 99-te", leshuar nga Ministria e Kultures, Keshilli Kombetar i Restaurimit" pasi prej 3 vjet nuk jepen Licence me objektin e mesiper, prej organit leshues. Eksperti Fotjon Qirinxi ka mbi 7 vjet nga diplomimi dhe ploteson kriterin per licencim pasi pervec diplomes si arkitekt gezon edhe titullin/graden Master Profesional ne Restaurim monumentesh kulture prej me shume se dy vitesh. Gjithashtu ne si shoqeri kemi paraqitur kerkese prane Institutit te Monumenteve te Kultures per interpretim dhe qartesis mbi kriterin e kerkuar, preventivin e punimeve dhe objektit te prokurimit. Ne pergjigjen e dhene prej Institutit te Monumenteve te Kultures na eshte interpretuar se Licenca e zbatimit qe kerkohet ne DST nevojitet vetem ne rastet kur ka nderyrje restauruese ne pamjen e jashtme te monumentit. Ne rastin konkret kemi nderhyrje ne tarace dhe bodrume.

2. Lidhur me arsyen e dyte te skualifikimit ankuesi pretendon se BOE ka paraqitur mjekun Pavlina T. me licence Nr. 121, date 26.10.2015 dhe skualifikimi eshte i padrejte per mungese te mjekut te licencuar pasi ne SPE eshte ngarkuar dokumentacioni i mjekut dhe se nje mjek eshte i mjaftueshem per realizimin me sukses te kontrates.

3. Lidhur me arsyen e trete te skualifikimit ankuesi pretendon se oferta behet me preventive dhe cmime per njesi, dhe nuk ofertohet me analize cmimesh. Edhe nese AK do te kishte pikepyetje mbi nje cmim te caktuar mund te kerkonte analize cmimesh apo sqarime mbi kostot e cmimit perkates, por kurrresi te refuzonte nje oferte fituese.

Ne keto kushte konstatohet se ankesa ploteson kushtet formale te saj dhe duhet te merret ne shqyrtim.

II. TRAJTIMI I PRETENDIMEVE TE NGRITURA:

1. Lidhur me pretendimin e pare Tuajin verehet se:

Ne piken 2.3.3 te Krieteve te Vecanta te Kualifikimit, nga ana e AK eshte percaktuar si me poshte:

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me:

c) Me license “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës” për shoqëri ndërtimi, sipas kategorisë “Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të”, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

ose

d) Duhet të ketë të punësuar ekspert që zotëron licensë profesionale “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës”, sipas kategorisë “Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të”, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, B.O.E. 6D-PLAN shpk dhe 2Z KONSTRUKSION shpk, vetëm shoqëria 2Z KONSTRUKSION ka paraqitur dokumentacionin e plote për të përmbushur kriterin e mesiperm. Referuar kontrates së bashkimit të operatoreve Nr. 1980 rep., Nr. 655 kol., lidhur pranë noterit Kadri Bilali, është percaktuar se palet do të kryejnë secila 50 % të zerave të preventivit. Pra rezulton se shoqëria 6D-PLAN shpk do të kryejë edhe punime për të cilat kerkohet detyrimisht pasja e licences së shoqërisë apo ekspertit me licensë profesionale për punimet e restaurimit. Keto punime si veshje e fasades me mermer, suva fasade mur guri, larje e pastrim i themeleve të gurit etj, kërkojnë pasjen e kapacitetit tekniko-ligjor për realizimin e tyre. Mungesa e licences përben kusht për skualifikim.

Lidhur me pretendimin se në rastin konkret kemi të bëjmë me nderhyrje në tarrace dhe bodrume dhe jo të pamjes së jashtme, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mesiperme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të vecanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontrates në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik". Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose menyrës së plotësimit të kriterëve kualifikues. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mesiperme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-se. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se "Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave."

Sa me sipër pretendimi Juaj nuk qëndron.

2. Lidhur me pretendimin detyrues Tuajin verëhet se:

Në pikën 2.3.8 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, nga ana e AK është kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të

përgjithshëm.(Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 "Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)"

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, operatori 6-D PLAN shpk ka paraqitur dokumentacionin për mjekun Jonel Ngjelina, por nuk ka paraqitur urdherin e mjekut. Edhe vete operatori e pranon se nuk ka paraqitur dokumentacionin e plote kur thekson në ankese se "duke besuar se një mjek është i mjaftueshëm për realizimin e kontratës". Në rast se operatori ekonomik ankimes do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mesipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të vecanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomike mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik".

Sa me sipër pretendimi Juaj nuk qëndron,

3. Lidhur me pretendimin e tretë Tuajin verëhet se:

Në pikën 2.3.13 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, nga ana e AK është kërkuar Analiza e Cmimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, B.O.E. 60-PLAN shpk dhe 2Z KONSTRUKSION shpk ka paraqitur analizën e cmimeve me vetëm 16 elemente të preventivit si dhe analizën e zerit "Punime elektrike". Nga shqyrtimi rezulton se analiza e cmimeve është e paplote dhe rrjedhimisht në mosplotësim të kriterit të parashikuar në DT. Lidhur me argumentin se oferta realizohet vetëm me preventiv dhe cmim për njësi, në rast se operatori ekonomik ankimes do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mesipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të vecanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomike mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik".

Lidhur me pretendimin se AK duhet të kërkonte sqarime, Neni 53, pika 1 LPP thotë se: "Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenin 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkojë, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në cmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme." Në rastin në fjalë çdo sqarim do të sillte kthimin e ofertës nga e pavlefshme në të vlefshme.

Sa me sipër pretendimi Juaj nuk qëndron.

PER KETO ARSYE: Bazuar në nenin 63 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Per prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe nenin 78 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", për shqyrtimin e ankesës, Autoriteti Kontraktor, VENDOSI: 1. Mospranimin e ankesës së B.O.E. 6D-PLAN shpk dhe 2Z KONSTRUKSION shpk.

2. *Kunder ketij akti mund te ushtrohet ankim prane Komisionit te Prokurimit Publik brenda 10 diteve nga dita e njoftimit te ketij vendimi ankuesit.*

II.5.3. Në datën 12.12.2019 bashkimi i operatorëve ekonomikë “6D - Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, në datën 22.11.2019 operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë:

1. *Nuk ka plotesuar piken 2.3.3 për kapacitetin teknik te kriterëve te veçanta te kualifikimit shtojca 12, pasi nuk ka paraqitur licencen e kërkuar te zbatimit për punimet e restaurimit ne monumentet e arkitektures “per shoqëri ndertimi, sipas kategorise” Zbatim ne restaurimin e ndertimeve civile monumenteve te kategorise se I-re dhe II-te.*
2. *Pika 2.3.13: Mungon analiza teknike e cmimeve.*

II.6.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k. në datën 02.12.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit, sipas vlerësimit të datës 22.11.2019.

II.6.2. Gjithashtu, referuar informacionit të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga autoritetit kontraktor, ky i fundit ka bashkëlidhur shkresën nr.1422/42 prot., datë 06.12.2019 me anë të së cilës ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik “Colombo” sh.p.k. Operatori ekonomik ankimes pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me kthimin e përgjigjes në datë 09.12.2019.

II.6.3. Referuar ankesës së operatorit ekonomik “Colombo” sh.p.k., dokumentacionit bashkëlidhur saj, informacionit të autoritetit kontraktor dhe dokumentacionit bashkëlidhur, konstatohet së në datë 11.12.2019 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “2N” sh.p.k. me arsyetimin si më poshtë:

[...]Operatori ekonomik COLOMBO SHPK pjesmarres ne kete procedure duke mos qene dakort per vleresimin e ofertave dhe skualifikimin tone ka paraqitur ankese ne date 26.11.2019 tek AK ne kete rast Universiteti i MjeksiseTirane, nepermjet rruges zyrtare. Ne daten 09.12.2019 prane ambjenteve te shoqerise sone, nepermjet rruges postare jemi njohur me vendimin: Kthim Pergjigjen Nr 1422/47 Prot ne date 06.12.2019 ku Autoriteti Kontraktor nepermjet Komisionit te Rivleresimit te Ofertave ka vendosur : ·

I. Pranimin e plote te ankeses se Operatorit Ekonomike COLOMBO SH,P,K duke e kualifikuar ate.

Nga ana jone si operatore ekonomike pjesmarres ne kete procedure publike kemi verejtur se AK nuk ka mbajtur te njejtin arsyetim, llogjike dhe standarte ne vleresim e operatoreve ekonomik duke bere keshtu nje vleresim ne menyre te njeanshme dhe jo ligjore:

Konkretisht ne baze te klasifikimit te ofertave te OE per kete procedure nga ana e AK ne shprehim rezervat konkretisht per Operatorin Ekonomike te kualifikuar ne kete rast shoqerine 2N SH.P.K. Konkretisht 2N SH.P.K nuk ka permbushur kriteret e DST te vendosura nga ju si AK per keto pika 2.3.6 operatoret Ekonomik pjesemarres duhet te kene ne stafin e tyre dhe te figurojne si drejtues teknik ne licencen e shoqerise si dhe ne listpagesat e shoqerise per 6 (gjashte) muajt e fundit, vertetuar me kontrate puue te vlefshme dhe diplome;

- Inxhinier ndertimi I (nje)

- Arkitekt I (nje)

- Inxh Elektrik I (nje)

- Inxhinier mjedisi I (nje)

- Inxhinier hidroteknik I (nje)

Ing.Elektrike i paraqitur nga ana e shoqerise 2N SH.P.K konkretisht Ing.Arlind Sauli nuk figuron ne Listepagesat e kompanise 2N SH.P.K per periudhen Mars-Prill 2019. Gjithashtu drejtuesit teknike te kompanise 2N SH.P.K konkretisht:

• Ing. Arlind Sauli

• Ing.Naim Hoxha

• Ing.Bertina Mehmeti

• Ing.Naita Meomali Hazizaj

• Ing.Jollanda Kosta Feshti

• Ing.Haziz Arifaj

• Ing e sipercitaur te cilet jane drejtues teknike dhe pjese perberese ne "Licencat profesionale te shoqerise" sipas pikes "g", kerkuar ne DST, ne listepagesat sipas formuleve standart per sigurimet, per gjashte muajte fundit, rezultojne te jene me 13 dite pune ne kundershjim me ligjin qe i kerkon drejtuesat teknike me kohe te plote pune pra me 22 dite.

Referuar ketij konstatimi rezulton se shoqeria 2N SH.P.K nuk ka permbushur kriterin per Ing.Elektrik i cili nuk figuron ne Listepagesa per muajt Mars dhe Prill 2019 si dhe per drejtuesit teknik te cilet jane te punesuar me 13 dite pune dhe jo me kohe te plote me 22 dite pune.

Per sa me siper kerkojme nga ana juaj si Ak rivleresimin edhe njehere te dokumentacionit te shoqerise 2N SH.P.K dhe skualifikimin e saj per mospermbushje te kriterëve te DST konkretisht pika 2.3.6.

Persa i perket pikes:

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete pjese te stafit te punesuar, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, Urdher mjeku, diplome, libeze pune dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten 6 (gjashte) muajt e fundit, 1 (nje) mjek te pergjithshem. Ne rastin e bashkimit te Operatoreve ekonomike, secili prej Operatoreve duhet te kete pjese te stafit te tij 1 (nje) mjek te pergjithshem. (Ne mbeshitetje te VKM Nr. 692 date 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, date 06.11.2003 "Per masat e vecanta te sigurimit dhe mbrojtjes se shendetit ne pune", Neni 12/1 Operoret ekonomik pjesemarres qe kane te punesuar me pak se 15 (pesembedhete) punonjes nuk kane detyrim ligjor plotesimin e kerkeses se mesiperme.)

OE ne kete rast shoqeria 2N SH.P.K nuk ka paraqitur ne kete procedure Mjek me kontrate pune te vlefshme, Urdher Mjeku, Diplome, Libreze pune dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te p akten 6 muajt e fundit per arsye sepse kjo shoqeri nuk zoteron nje mjek te tille. Shoqeria 2 N kaper periudhen e kerkuar ne DST, nje punesim mujor mbi 15 punonjes dhe detyrimisht duhet te kishin te punesuar mjekun prane subjektit si detyrim ligjor qe rrjedh nga VKM nr.692 ,date

13.12.2001 "Per masat e vecanta te sigurimit dhe mbrojtjes se shendetit ne pune, i ndryshuar me VKM Nr.742, date 06.11.2003.

Per sa me siper kerkojme nga ana juaj si Ak rivleresimin edhe njehere te dokumentacionit te shoqerise 2N SH.P.K dhe skualifikimin e saj per mospermbushje te kritereve te DST konkretisht pika 2.3.8

Persa i perket pikes:

2.3 Per kapacitetin teknik:

2.3.1 Per te provuar pervojjen e meparshme, autoriteti kontraktor kerkon:

- a) pune te ngjashme per nje objekt te vetem me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.
- b) pune te ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është nje vlere sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Deklaratën sipas shtojcës Nr.9, shoqëruar me:
- Kontratë
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim.
- Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Deklaratën sipas shtojcës Nr.9, shoqëruar me:
- Kontrate;
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
- Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Nuk do te merret në konsideratë asnje punim i pavertetuar.

OE ne kete rast shoqeria 2N SH.P.K ka paraqitur nje pune te ngjashme ku nuk perputhet me kerkesat qe Autoriteti Kontraktor ka kerkuar ne DST. Sqarojme se operatori ekonomik ka paraqitur per pune te ngjashme, realizuar me sektorin privat, kontrata bashkepunimi me shoqerine SION-AL Shpk ku firma "2N" eshte nenkontraktore e shoqerise SION-AL, Autoriteti Kontraktor ne DST ka kerkuar se ne rastin e perveses meparshme te realizuar me sektorin privat kerkohen si deshmi: 1.Vertetime (dokumente) ku te shenohen vlera, koha dhe natyra e punes se here, e shoqeruar me, situacionin perfundimtar, certifikaten e marrjes ne dorezim te objektit, fatura tatimore dhe aktin e kolaudimit perfundimtar per te vertetuar permbushjen e suksesshme te

puneve. Theksojme se ne Aktin e Kolaudimit qe ka paraqitur figuron qe firma SION-AL Shpk eshte edhe subjekt ndertues edhe investitor, kurse OE "2N" nuk figuron fare ne Akt Kolaudim.

Per sa me siper kerkojme nga ana juaj si Ak rivleresimin edhe njehere te dokumentacionit te shoqerise 2N SH.P.K dhe skualifikimin e saj per mospermbushje te kriterëve te DST konkretisht pika 2.3.1

Persa i perket pikes :

2. Kritere Te Vecanta per Kualifikim

Pika g. Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojces 11;

OE ne kete rast shoqeria 2N SH.P.K tek Deklarata e puneve ne proces eshte e paplote duke mos permbajtur te dhena te sakta, pasi nuk jane deklaruar 2 kontrata te nenshkruara nga subjekti dhe qe jane ne proces e siper. Konkretisht me date 01.08.2019 jane nenshkruar 2 kontrata me Bashkine Durrës, ku shoqeria 2N eshte pale kontraktore, perkatesisht kontrata me objekte "Rikonstruksion kopshti 1 Maji" dhe "Rikonstruksion rruga Zeqai Spahiu", keto kontrata kane afat 2 mujor dhe rezultojne Akoma te paperfunduara, nderkohe qe nuk rezultojne te jene deklaruar si pune ne proces.

Per sa me siper kerkojme nga ana juaj si Ak rivleresimin edhe njehere te dokumentacionit te shoqerise 2N SH.P.K dhe skualifikimin e saj per mospermbushje te kriterëve te DST konkretisht pika g.

2.1 Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese Kopje te certifikuara te bilanceve te 2 (dy) viteve te fundit ushtrimore (2017, 2018), te paraqitur ne autoritetet perkatese Dega e Tatim Taksave te konfirmuara nga ky autoritet si dhe te shoqeruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar.

OE ne kete rast shoqeria 2N SH.P.K i mungon raporti i auditimit per pasqyrat financiare 2018.

Per sa me siper kerkojme nga ana juaj si Ak rivleresimin edhe njehere te dokumentacionit te shoqerise 2N SH.P.K dhe skualifikimin e saj per mospermbushje te kriterëve te DST konkretisht pika 2.2.1

Duke pare te gjithë dokumentacionin e kompanise 2N SH.P.K dhe dokumentacionit te paplotesuar nga ana e kesaj shoqerie per pikat e kriterëve ne DST te hartuar nga AK ne kerkojme skualifikimin e shoqerise 2N SH.P.K dhe shpalljen fitues te shoqerise COLOMBO SH.P.K si oferta me e sukseshme e cila ploteson te gjitha pikat e DST.

Perfundimisht kerkojme: 1. Pezullimin e procedures dhe shgyrtimin e ankeses sone. 2. S'Kualifikimin e OE 2N SH.P.K dhe shpalljen fitues te OE COLOMBO SH.P.K nga ana e Autoritetit Kontraktor.

II.6.4. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se në datë 21.12.2019 ka marrë dijëni për shkresën me nr.1422/47 prot., datë 16.12.2019, me anë të së cilës autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor argumenton:

[...] Në vijim të ankesës suaj protokolluar me tonën me nr. 1422/45 prot., datë 11.12.2019, "Formular ankese pranë Autoritetit Kontraktor", për procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i tarracës së paraklinikut dhe bodrumeve të dekanatit të FM-së", me fond limit 16.399.882 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.09.2019, nga autoriteti kontraktor, me Ref-34050-08-21-2019, ju sqarojmë si më poshtë:

I. Rrethanat e Faktit

-Ankuesi ka pjesë si ofertues në tenderin e zhvilluar me date 30.09.2019 nga autoriteti kontraktor Universiteti I Mjekësisë Tiranë, me objekt "Rikonstruksioni i tarracës së paraklinikut dhe bodrumeve të dekanatit të FM-së", ku në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, KVO fillimisht ka skualifikuar ofertën e paraqitur nga operatori Colombo sh.p.k.

- Në datën 22.11.2019, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka përfunduar me fazën e vlerësimit të ofertave dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave, sipas të cilit rezulton se operatori ekonomik 2N sh.p.k. është i klasifikuar si oferta e parë e suksesshme dhe operatori Colombo sh.p.k. skualifikuar.

- Në datën 02.12.2019, nga ana e operatorit Colombo sh.p.k., është paraqitur ankesa e parë pranë Fakultetit të Mjekësisë Tiranë, protokolluar me Nr.1422, datë 02.12.2019.

- Pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit Colombo shpk, me shqyrtimin e ankesës vendosi pranimin e plotë të ankesës së operatorit duke e kualifikuar kete operator.

- Pas pranimit të ankesës dhe njoftimit të operatorit me shkresën Kthim Përgjigje Nr.1422/47, datë 06.12.2019, rezulton se operatori Colombo sh.p.k. ka marrë dijëni në datën 09.12.2019 dhe ka paraqitur ankesën e dytë Nr.1422/45 prot., datë 11.12.2019.

Nga permbajtja e ankeses se dyte rezulton se ankuesi nuk eshte dakort me klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe kualifikimin e ofertes se operatorit 2N shpk, duke ngritur pretendimet sipas ankeses,

II. VLERESIMI PARAPRAK

Pas shqyrtimit paraprak te ankeses te mbeshtetur ne dokumentacionin e derguar nga operatori ekonomik ankimes, konstatohet se operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, ne daten 02.12.2019. Ne kete ankesë, operatori ka paraqitur vetem pretendime lidhur me subjektin e tij, dhe jo pretendime per subjektet e tjera konkurruese ne kete procedure, perfshire subjektin 2N shpk.

Me marrjen e pergjigjes lidhur me ankesen e pare, operatori ka paraqitur serish ankesë, duke ngritur pretendime te reja, te paparaqitura ne ankesen e pare. Ankesa e pare e operatorit eshte trajtuar e plote dhe ne respekt te Nenit 139, pika 1 te Kodit te Procedurave Administrative ku parashikohet se: "... arsyetimi i aktit administrativ qe zgjidh ankimin, permban edhe nje vleresim te te gjitha pretendimeve te parashtruara nga pala ne ankim".

Sjellim ne vemendje nenin 63 te ligjit nr. 9643, dt.20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, ne te cilin eshte parashikuar: "1. Cdo person, qe ka ose ka pasur interes ne nje procedure prokurimi dhe kur eshte demtuar ose rrezikohet te demtohet nga nje vendim i autoritetit kontraktor, i marre ne kundërshtim me kete ligj, mund ta kundërshtoje vendimin. 2. Ankesa kunder vendimeve te autoritetit kontraktor i paraqitet, se pari, me shkrim, autoritetit kontraktor ne fjale brenda 7 diteve nga dita e nesërme e punes kur ankimesi eshte vene ne dijëni ose duhet te ishte vene ne dijëni per shkeljen e pretenduar, sipas ketij ligji. 5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesen dhe merr nje vendim te arsyetuar brenda 7 diteve pas marrjes se ankeses, te cilin duhet t'ia njoftoje ankuesitjo me vone se ne ditën vijuese te punes. "

Ne interpretimin gjuhesor te dispozites se sipercituar, afati i ankimit administrativ prane autoritetit kontraktor nis qe ditën e nesërme te punes kur ankuesi eshte vene ne dijëni ose duhet te ishte vene ne dijëni. Ky afat eshte 7 dite. Njoftimi fillestar eshte kryer ne daten 22.11.2019, e cila eshte dite e shtune. Afati 7 dite fillon nga dita e punes data 25.11.2019 dhe mbaron ne daten 01.12.2019 e cila eshte dite e diele. Sipas dispozitave te Kodit te Procedurave Administrative, nese

dita e afatit mbaron ditën e pushimit, atehere shtyhet për ditën e parë të punës që është dita e hënë data 02.12.2019. Në këtë datë rezultoi se ankuesi ka paraqitur ankesë brenda afatit, por në këtë ankesë nuk janë paraqitur pretendimet e ankuesit lidhur me operatorin e tjerë e as lidhur me operatorin 2N shpk. Për rezultoi se operatori COLOMBO shpk e ka ditur vendimin e autoritetit kontraktor për të kualifikuar operatorin 2N shpk që në datën 22.11.2019, ku ka marrë dëgjimin nga sistemi SPE për renditjen e operatorëve dhe kualifikimin e tyre, madje e ka paraqitur edhe njoftimin në të dy ankesat e tij. Ky vendim për kualifikimin e operatorit 2N shpk nuk ka ardhur si pasoje e veprimeve apo ankesave të mëposhtme të shqyrtuara nga autoriteti kontraktor.

Ankesa e re rezultoi të jetë paraqitur në datën 11.12.2019, pra jashtë afatit ligjor. Për këtë arsye, ankesa e paraqitur prej operatorit ekonomik ankues është pas përfundimit të afatit të parashikuar nga nenin 63 pika 1.1. të L.P.P.-se, duke mos u legjitimuar racione temporis në dorezimin e ankesës tjetër pranë Autoritetit Kontraktor. Operatori COLOMBO shpk ka patur mundësinë ligjore të paraqiste këto pretendime në ankesën e tij të parë të realizuar brenda afatit ligjor.

Sa më sipër, zyrtari i ngarkuar, gjykon se, ankesa e re e dorëzuar nga operatori ekonomik ankues "COLOMBO" sh.p.k., nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njerin nga "elementet e domosdoshme të ankesës" që përben shkak për mospranimin e ankesës, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Ritheksojme bindjen se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (nder të dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e më ndikim të drejtperdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis mbi lenden*. Ky parashikim gjendet edhe në Nenin 136, pika 1 Kodi i Procedurave Administrative ku thuhet se: "organi publik kompetent fillimisht shqyrton nëse ankimi është i pranueshëm dhe vetëm nëse ankimi është i pranueshëm, shqyrton ligjshmerinë dhe përshtatshmerinë e aktit administrativ të ankimit".

Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas Ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankues pranë autoritetit kontraktor nuk mund të konsiderohet si pasoje e ezaurimit të afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vete ankuesit, ankimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

PER KETO ARSYE: Bazuar në nenin 63 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe nenin 78 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës, **VENDOSI:** 1. Të mos pranojë ankesën e operatorit COLOMBO shpk. 2. Kunder këtij akti mund të ushtrohet ankim pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi ankuesit.

II.6.5. Në datën 26.12.2019 operatori ekonomik "Colombo" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjta pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik ankues, në ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik ka sqaruar se:

[...] Ne daten 30.09.2019, Autoriteti Kontraktor, Universiteti i Mjekesise Tirane zhvilloi proceduren e Hapur te Prokurimit me objekt: "Rikonstruksioni i tarraces se paraklinikut dhe bodrumeve te dekanatit te FM-se", me fond limit 16 399 882 (gjashtembedhjetë milion e treqind e nentëdhjetë e netë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) Leke pa Tvsh, ku shoqeria COLOMBO SHPK ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar dhe oferten e saj.

Oferta ekonomike e ofertuar prej shoqerise tone per kryerjen e punimeve, ishte ne vleren 16 399 882 Leke pa TVSH. Ne daten 22.11.2019 autoriteti kontraktor njoftoi Operatoret ekonomik pjesemarres, nepermjet sistemit te prokurimeve elektronike(S.P.E), mbi rezultatet e shqyrtimit dhe vleresimit te ofertave nga ku rezulton se kane qene keto operatore ekonomike pjesemarres :

Pas kualifikimit te ofertes sone nga ana e AK vleresimi i ofertave eshte si me poshte:

Operatore Ekonomike	Vlera te ofertuara:	Refuzuar
Elda-VL	0.00	Po
60-Plan	12283886.00	Po
Ante-Group	12501779.50	Po
<u>2N</u>	<u>12789616.00</u>	<u>Jo</u>
COLOMBO	13081250.00	Po
KACDEDJA	13111837.00	Po
LEON KONSTRUKSION	13117888.42	Jo
Viante Konstruksion	13119806.00	Jo
JOGI	13307228.00	Jo
SENKA	136742277.20	Jo
KARL GEGA Konstruksion	13757308.30	Jo
ALB-TIEFAU	14431454.00	Jo
AD Star	15252229.96	Jo
Aurora Konstruksion	15496484.00	Jo

Operatori ekonomik COLOMBO SHPK pjesemarres ne kete procedure eshte skualifikuar per arsyet e meposhtme:

1) Nuk ka plotesuar piken 2.3.3 per kapacitetin teknik te kriterëve te vecanta te kualifikimit shtojca 12, pasi nuk ka paraqitur licencen e kerkuar te Zbatimit per punimet e resaturimit ne monumetet e arkitektures "per shoqeri ndertimi, sipas kategorise "Zbatim ne restaurimin e ndertimeve civile monumenteve te kategorise se I-re dhe II-te.

2) Pika 2.3.13 :Mungon analiza teknike e cmimeve.

Operatori ekonomik COLOMBO SHPK pjesemarres ne kete procedure duke mos qene dakort per vleresimin e ofertave dhe skualifikimin tone ka paraqitur ankese ne date 26.11.2019 tek AK ne kete rast Universiteti i Mjekesise Tirane nepermjet rruges zyrtare. Ne daten 09.12.2019 prane ambjenteve te shoqerise sone, nepermjet rruges postare jemi njohur me vendimin: Kthim Pergjigjen Nr 1422/47 Prot ne date 06.12.2019 ku Autoriteti Kontraktor nepermjet Komisionit te Rivleresimit te Ofertave ka vendosur:

1. Pranimin e plote te ankeses se Operatorit Ekonomike COLOMBO SH.P.K duke e kualifikuar ate.

Pas kualifikimit te ofertes sone nga ana e AK vleresimi i ofertave eshte si me poshte:

Operatore Ekonomike	Vlera te ofertuara:	Refuzuar
Elda-VL	0.00	Po

60-Plan	12283886.00	Po
Ante-Group	12501779.50	Po
2N	12789616.00	Jo
COLOMBO	13081250.00	Jo
KACDEDJA	13111837.00	Po
LEON KONSTRUKSION	13117888.42	Jo
Viante Konstruksion	13119806.00	Jo
JOGI	13307228.00	Jo
SENKA	136742277.20	Jo
KARL GEGA Konstruksion	13757308.30	Jo
ALB-TIEFAU	14431454.00	Jo
AD Star	15252229.96	Jo
Aurora Konstruksion	15496484.00	Jo

Ne zyrtat tona dt.06.12.2019 me nr 142247 Prot Autoriteti Kontraktor ka njoftuar shoqerin Colombo shpk se eshte pranuar ankesa dhe se shoqeria Colombo Shpk kualifikohet per kete procedure, Colombo shpk i drejtohet Autoritetit Kontraktor per skualifikimin e shoqerise 2N SHPK. Autoriteti Kontraktor ka derguar shkrese zyrtare dt 16.12.2019 mbritur ne zyren tone me dt 21/12/2019 ku shprehet se ankimi eshte jashte kohe. Autoriteti argumenton se duhej bere edhe ankimi dhe per skualifikimin e shoqerise 2N SHPK ne momentin qe i jemi drejtuar Autoritetit per kuakifikimin e shoqerise COLOMBO SHPK. Ne ankesen e pare te dates 26.11.2019 ku shoqeria jone COLOMBO SHPK ka paraqitur ankese per skualifikimin e saj me dt 17.12.2019 jemi njoftuar ne SPE per rivleresimin edhe njehere te procedures dhe kualifikimin e operatorit tone COLOMBO SHPK. Ne baze ligjore shoqeria jone COLOMBO SHPK nuk munde te ankohet per shoqeri te tjera pjesmarrese ne kete procedure ne rast se nuk dote merrte kualifikimin e saj, ndaj ne nuk munde te paraqisim dot ne ankesen e pare kualifikimin e operatorit tone Colombo Shpk dhe skualifikimin e operatorit 2N SHPK pasi kjo nuk ka baze ligjore. Per sa me siper ankesa jone eshte konform ligjit dhe brenda afateve.

Nga ana jone si operatore ekonomike pjesmarres ne kete procedure publike kemi verejtur se AK nuk ka mbajtur te njejtin arsyetim, llogjike dhe standarte ne vleresim e operatoreve ekonomik duke bere keshtu nje vleresim ne menyre te njeanshme dhe jo ligjore:

Konkretisht ne baze te klasifikimit te ofertave te OE per kete procedure nga ana e AK ne shprehim rezervat konkretisht per Operatorin Ekonomike te kualifikuar me kete rast shoqerine 2N SH.P.K. Konkretisht Shoqeria 2N SHPK nuk ka permbushur kriteret e DST te vendosura nga Ak per keto pika:

Pika 2.3.6 Operoret Ekonomik pjesemarres duhet te kene ne stafin e tyre dhe te figurojne si drejtues teknik ne licencen e shoqerise si dhe ne listpagesat e shoqerise per 6 (gjashte) muajt e fundit. Vertetuar me kontrate pune te vlefshme dhe diplome:

- Inxhinier ndertimi I (nje)
- Arkitekt I (nje)
- Inxh Elektrik I (nje)
- Inxhinier mjedisi I (nje)
- Inxhinier hidroteknik I (nje)

Ing. Elektrike i paraqitur nga ana e shoqerise 2N SH.P.K konkretisht Ing. Arlind Sauli nuk figuron ne Listepagesat e kompanise 2N SH.P.K per periudhen Mars-Prill 2019. Gjithashtu drejtuesit teknike te kompanise 2N SH.P.K konkretisht:

- *Ing. Arlind Sauli*
- *Ing. Naim Hoxha*
- *Ing. Bertina Mehmeti*
- *Ing. Naita Meomali Hazizaj*
- *Ing. Jollanda Kosta Feshti*
- *Ing. Haziz Arifaj*
- *Ing e sipercitaur te cilet jane drejtues teknike dhe pjese perberese ne "Licencat profesionale te shoqerise" sipas pikes "g", kerkuar ne DST, ne listepagesat sipas formuleve standart per sigurimet, per gjashte muajte fundit, rezultojne te jene me 13 dite pune ne kundershijm me ligjin qe i kerkon drejtuesat teknike me kohe te plote pune pra me 22 dite.*

Referuar ketij konstatimi rezulton se shoqeria 2N SH.P.K nuk ka permbushur kriterin per Ing. Elektrik i cili nuk figuron ne Listepagesa per muajt Mars dhe Prill 2019 si dhe per drejtuesit teknik te cilet jane te punesuar me 13 dite pune dhe jo me kohe te plote me 22 dite pune.

Per sa me siper kerkojme nga ana juaj si Ak rivleresimin edhe njehere te dokumentacionit te shoqerise 2N SH.P.K dhe skualifikimin e saj per mospermbushje te kriterëve te DST konkretisht pika 2.3.6.

Persa i perket pikes:

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete pjese te stafit te punesuar, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, Urdher mjeku, diplome, libreze pune dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten 6 (gjashte) muajt e fundit, 1 (nje) mjek te pergjithshem. Ne rastin e bashkimit te Operatoreve ekonomike, secili prej Operatoreve duhet te kete pjese te stafit te tij 1 (nje) mjek te pergjithshem. (Ne mbeshtetje te VKM Nr. 692 date 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, date 06.11.2003 "Per masat e vecanta te sigurimit dhe mbrojtjes se shendetit ne pune", Neni 12/1 Operoret ekonomik pjesmarres qe kane te punesuar me pak se 15 (pesembedhete) punonjes nuk kane detyrim ligjor plotesimin e kerkeses se mesiperme.)

OE ne kete rast shoqeria 2N SH.P.K nuk ka paraqitur ne kete procedure Mjek me kontrate pune te vlefshme, Urdher Mjeku, Diplome, Libreze pune dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te p akten 6 muajt e fundit per arsye sepse kjo shoqeri nuk zoteron nje mjek te tille. Shoqeria 2 N kaper periudhen e kerkuar ne DST, nje punesim mujor mbi 15 punonjes dhe detyrimisht duhet te kishin te punesuar mjekun prane subjektit si detyrim ligjor qe rrjedh nga VKM nr.692 ,date 13.12.2001 "Per masat e vecanta te sigurimit dhe mbrojtjes se shendetit ne pune, i ndryshuar me VKM Nr.742, date 06.11.2003.

Per sa me siper kerkojme nga ana juaj si Ak rivleresimin edhe njehere te dokumentacionit te shoqerise 2N SH.P.K dhe skualifikimin e saj per mospermbushje te kriterëve te DST konkretisht pika 2.3.8

Persa i perket pikes:

2.3 Per kapacitetin teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- c) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*
- d) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë*

së bashku gjatë tri viteve të fundit, është një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Deklaratën sipas shtojcës Nr.9, shoqëruar me:
- Kontratë
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes në dorezim.
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Deklaratën sipas shtojcës Nr.9, shoqëruar me:
- Kontrate;
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;
- Çertifikaten e marrjes në dorezim të objektit;
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Nuk do të merret në konsideratë asnjë punim i pavartetuar.

OE në këtë rast shoqëria 2N SH.P.K ka paraqitur një punë të ngjashme ku nuk përputhet me kërkesat që Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në DST. Sqarojmë se operatori ekonomik ka paraqitur për punë të ngjashme, realizuar me sektorin privat, kontrata bashkëpunimi me shoqërinë SION-AL Shpk ku firma "2N" është nenkontraktore e shoqërisë SION-AL, Autoriteti Kontraktor në DST ka kërkuar se në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat kerkohen si dëshmi: 1. Vertetime (dokumente) ku të shenohen vlera, koha dhe natyra e punës së here, e shoqëruar me, situacionin përfundimtar, certifikaten e marrjes në dorezim të objektit, fatura tatimore dhe aktin e kolaudimit përfundimtar për të vertetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Theksojmë se në Aktin e Kolaudimit që ka paraqitur figuron që firma SION-AL Shpk është edhe subjekt ndertues edhe investitor, kurse OE "2N" nuk figuron fare në Akt Kolaudim.

Për sa me sipër kërkojmë nga ana juaj si Ak rivleresimin edhe njëherë të dokumentacionit të shoqërisë 2N SH.P.K dhe skualifikimin e saj për mospërmbushje të kriterëve të DST konkretisht pika 2.3.1

Përsa i përket pikës :

2. Kriteret e Vecanta për Kualifikim

Pika g. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces, sipas Shtojcës 11;

OE në këtë rast shoqëria 2N SH.P.K tek Deklarata e punëve në proces është e paplote duke mos përmbajtur të dhëna të sakta, pasi nuk janë deklaruar 2 kontrata të nënshkruara nga subjekti dhe që janë në proces e sipër. Konkretisht me datë 01.08.2019 janë nënshkruar 2 kontrata me Bashkinë Durrës, ku shoqëria 2N është pale kontraktore, perkatesisht kontrata me objekte "Rikonstruksion

kopshti 1 Maji" dhe "Rikonstruksion rruga Zeqai Spahiu", keto kontrata kane afat 2 mujor dhe rezultojne Akoma te paperfunduara, nderkohe qe nuk rezultojne te jene deklaruar si pune ne proces.

Per sa me siper kerkojme nga ana juaj si Ak rivleresimin edhe njehere te dokumentacionit te shoqerise 2N SH.P.K dhe skualifikimin e saj per mospermbushje te kritereve te DST konkretisht pika g.

2.1 Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese Kopje te certifikuara te bilanceve te 2 (dy) viteve te fundit ushtrimore (2017, 2018), te paraqitur ne autoritetet perkatese Dega e Tatim Taksave te konfirmuara nga ky autoritet si dhe te shoqeruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar.

OE ne kete rast shoqeria 2N SH.P.K i mungon raporti i auditimit per pasqyrat financiare 2018.

Per sa me siper kerkojme nga ana juaj si Ak rivleresimin edhe njehere te dokumentacionit te shoqerise 2N SH.P.K dhe skualifikimin e saj per mospermbushje te kritereve te DST konkretisht pika 2.2.1

Duke pare te gjithe dokumentacionin e kompanise 2N SH.P.K dhe dokumentacionit te paplotesuar nga ana e kesaj shoqerie per pikat e kritereve ne DST te hartuar nga AK ne kerkojme skualifikimin e shoqerise 2N SH.P.K dhe shpalljen fitues te shoqerise COLOMBO SH.P.K si oferta me e suksesshme e cila ploteson te gjitha pikat e DST.

Perfundimisht kerkojme: 1. Pezullimin e procedures dhe shgyrtimin e ankeses sone. 2. S'Kualifikimin e OE 2N SH.P.K dhe shpalljen fitues te OE COLOMBO SH.P.K nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Ne daten 26.11.2019 brenda afateve ligjore te paraqitjes se ankimit prane Autoritetit Kontraktor i drejtuar Autoritetit Kontraktor me paraqitjen e Formularit te Ankimit.

Autoriteti Kontraktor na ka kthyer pergjigje me shkrese zyrtare nr.142/47 prot date 06.12.2019 ku AK nepermjet KVO ka vendosur pranimin e plote te ankeses se OE COLOMBO SH.P.K duke e kualifikuar ate.

Ne daten 10.12.2019 brenda afateve ligjore OE COLOMBO SH.P.K ka paraqitur ankese per kualifikimin e OE 2N Sh.p.k duke shprehur rezerva pasi kjo shoqeri nuk ka plotesuar te gjitha pikat e DST te vendosura nga AK. AK na ka kthyer pergjigje ankeses sone date ne date 16.12.2019 ka ardhur ne zyrat e shoqerise sone ne date 21.12.2019 me asryet se ankesa ka qene jashte afateve kohore.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 1422/54 prot., datë 23.12.2019, protokolluar me tonën në datën 24.12.2019, me objekt “Dërgim informacioni”, si dhe shkresës nr. 1422/58 prot., datë 06.01.2020, protokolluar me tonën në datën 07.01.2020, me objekt “Dërgim informacioni” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “6D - Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “*Operatori ekonomik 6D Plan nuk ka licencën e kërkuar sipas dokumentave Standarte të Tenderit përsa i përket licencës së restauratorit, konkretisht pika 2.3.3 kapaciteti teknik, shtojca 12 kriteret e vecanta të kualifikimit*”, nuk qëndron, Komisioni i prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 12 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.3.3 e “Kapacitetit teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si më poshtë :

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me:

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur:

a) *Me license “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës” për shoqëri ndërtimi, sipas kategorisë “Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të”, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit.*

Ose

b) *Duhet të ketë të punësuar ekspert që zotëron licensë profesionale “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës”, sipas kategorisë “Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të”, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve “6D - Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin “*Deklaratë Bashkëpunimi për Bashkim të Përkohshëm të Operatorëve*”, ndërmjet shoqërisë “2Z Konstruksion” sh.p.k. dhe shoqërisë “6D - Plan” sh.p.k., nga ku shoqëria “2Z Konstruksion” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 50 % të zërave të punimeve të preventivit dhe shoqëria “6D - Plan” sh.p.k. 50 % të zërave të punimeve të preventivit.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “6D - Plan” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “6D - Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k., konstatohet se ky i fundit, për të përmbushur kriterin e mësipërm ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë punësimi Nr.2632 Rep. Nr.1767 Kol., datë 03.09.2018 ndërmjet punëdhënësit Z. S.K si administrator i shoqërisë “6D – Plan” sh.p.k. dhe punëmarrësit Z. F.Q, me detyrë Drejtues Teknik, arkitekt (restarotor).
- CV e z.F.Q
- Diplomë nr.4198 datë 27.09.2012 në emër të z.F.Q, dega Arkitekturë, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik Tiranë.

- Diplomë Master Profesional në Restaurim Monumentesh Kulture, në emër të z.F.Q, lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, datë 06.10.2017.
- Certificate to F.Q “In recognition of your successful participation and contribution in the Regional Restoration Camp”, Cultural Heritage without Borders – Albania.
- Certifikatë Kualifikimi Pasuniversitar me tematikë “Vlerësimi i Pasurive të Paluajtshme”, datë 30.03.2018, lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës për Z. F.Q.

III.1.4. Sipas ankimesit pretendohet se: *“Se pari: prej AK- Universiteti i Mjekesise Tirane ne prokurimin publik ne fjale, ne DST dhe ne sistemin elektronik ne faqen app.gov.al eshte kerkuar: 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me: a) Me license “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës” për shoqëri ndërtimi, sipas kategorisë “Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të”, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit. Ose b) Duhet të ketë të punësuar ekspert që zotëron licensë profesionale “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës”, sipas kategorisë “Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të”, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

Sa me siper kemi paraqitur dokumentacionin ku B.O.E. "6D-PLAN" sh.p.k., & 2Z KONSTRUKSION shpk prezanton si me poshte: Ekspertin: Fotjon Qirinxi. Eksperti i Lartepemendur ploteson kriterin e kerkuar "ekspert qe zoteron license profesionale "Zbatim per punimet e restaurimit ne monumentet e arkitektures", sipas kategorise "Zbatim ne restaurimin e ndertimeve civile monumenteve te kategorise se I-re dhe te II-te", leshuar nga Ministria e Kultures, Keshilli Kombetar i Restaurimit" pasi prej mbi 3 vjet, nuk jepen Licence me objektin e mesiper, prej organit leshues. Eksperti yne, ka mbi 7 vjet nga diplomimi dhe i ploteson kriterin per licencim pasi pervec Diplomes si arkitekt gezon dhe Titullin/Graden "Master Profesional ne "RESTAURIM MONUMETESH KULTURE" prej me shume se dy vitesh. Gjithashtu ne si shoqeri ofertuese kemi paraqitur kerkese prane "Institutit te Monumenteve te Kultures" per interpretim dhe qartesim mbi kriterin e kerkuar, preventivin e punimeve dhe objektin "Rikonstruksioni I tarraces se paraklinikut dhc bodrumeve te dekanatit tc FM-se". Ne Pergjigjen e dhene prej Autoritetit "Institutit te Monumenteve te Kultures", na eshte interpretuar se Licenca e zbatimit qe kerkohet ne DST, nevojitet vetem ne rastet kur ka "nderhyrje restauruese ne pamjen e jashtme te monumentit". Ne rastin konkret kemi nderhyrje ne Tarace dhe Bodrume. Gjithashtu edhe vet Projektuesi i nderhyrjes ne fjale nuk e Gezon Licencen e kerkuar ne projektim, dhe kerkohet ne zbatim. Sa mesiper mendojme se Autoriteti Kontraktor "Universiteti Mjekesise, Tirane" ka skualifikuar ne menyre te pa drejte : B.O.E. "6D-PLAN" sh.p.k., & 2Z KONSTRUKSION" shpk.

III.1.5. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.* Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të*

operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.6. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.7. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushurkontratën.

[...]

III.1.8. Referuar sa më sipër, KPP konstaton se, në kriteret e veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë një nga kushtet: Të disponojnë licensë “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës” për shoqëri ndërtimi, sipas kategorisë “Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të”, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit; ose duhet të kenë të punësuar ekspert që zotëron licensë profesionale “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës”, sipas kategorisë “Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të”, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Pra, sa më sipër, konstatohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të mësipërme, në mënyrë që të konsiderohet i përmbushur ky kriter.

III.1.9. Nisur nga pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, ky i fundit si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor ashtu dhe në ankesën e paraqitur pranë Komisionit

të Prokurimit Publik, argumenton se në përmbushje të kriterit të mësipëm ka paraqitur dokumentacionin për punonjësin Z. F.Q, i punësuar pranë shoqërisë “6D – Plan” sh.p.k. , me detyrë Drejtues Teknik, arkitekt (restarotor).

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “6D - Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k., për të përmbushur kriterin e mësipërm, konstatohet se ky i fundit nuk ka dorëzuar dokumentacionin e plotë në lidhje me ekspertin që zotëron licensë profesionale “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës [...]”. Konkretisht, konstatohet se operatori ekonomik “6D - Plan” sh.p.k., si një nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, për ekspertin e mësipërm, nuk ka paraqitur Licensën profesionale “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës”, sipas kategorisë “Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të”, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit, sikundër është kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit si më sipërcituar. Në këto kushte, KPP gjykon se, bashkimi i operatorëve ekonomikë “6D - Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, në të cilat kërkohet shprehimisht që operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë një nga kushtet e vendosura, konkretisht të disponojnë licensë “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës” për shoqëri ndërtimi, sipas kategorisë “Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të”, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit, ose të kenë të punësuar ekspert që zotëron licensë profesionale “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës”, sipas kategorisë “Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të”, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimit. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Akoma më tej, KPP gjykon se, ankimuesi i mësipërm ka marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi si bashkim operatorësh ndërmjet shoqërisë “2Z Konstruksion” sh.p.k. dhe shoqërisë “6D - Plan” sh.p.k., nga ku shoqëria “2Z Konstruksion” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 50 % të zërave të punimeve të preventivit dhe shoqëria “6D - Plan” sh.p.k. 50 % të zërave të punimeve të preventivit, rrjedhimisht, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e zërave të marra përsipër. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, konstatohet se për kriterin e mësipërm, është paraqitur dokumentacion vetëm për shoqërinë ”6D – Plan” sh.p.k., e cila në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të realizojë 50 % të zërave të preventivit, kështu që rrjedhimisht ky kriter duhet të plotësohet dhe nga anëtari tjetër i bashkimit, shoqëria ”2Z Konstruksion” sh.p.k.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “6D - Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi operatori ekonomik “6D - Plan” sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto

dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “6D - Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k., në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është konform kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

III.1.10. Akoma më tej, vlen të theksojmë se, në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor përsa i përket dokumentave të tenderit, publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.*

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së.

Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...].

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “6D - Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k., për arsyet e tjera të skualifikimit e ofertës së tij ekonomike, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, pasi bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk

përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi të operatorëve ekonomikë e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Colombo” sh.p.k. mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “2N” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.3.2. Neni 63, pika 2, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”*

III.3.3. Neni 63, pika 5, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.”*

III.3.4. Ndërsa Neni 63, pika 6, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.*

III.3.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga KPP, nëpërmjet ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Colombo” sh.p.k, si dhe informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1422/58 prot., datë 06.01.2020, rezulton se operatori ekonomik ankimues, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor për vendimin e marrë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për skualifikimin e ofertës e tij në datën 22.11.2019, ankesë e cila është pranuar nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se LPP parashikon në mënyrë eksplicite se për cdo vendimmarrje të autoritetit kontraktor, fillimisht operatorët ekonomike që rrezikojnë të dëmtohen nga ky vendim duhet të ushtrojnë të drejtën e ankimit pranë autoritetit kontraktor brenda afateve të parashikuara në LPP, duke respektuar të gjithë elementët formal sipas dispozitave ligjore. Operatori ekonomik ankimues “Colombo” sh.p.k, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor vetëm për vlerësimin e parë të kryer nga KVO në datën 21.11.2019, duke kundërshtuar vetëm vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike dhe nuk ka ngritur pretendime në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “2N” sh.p.k., i cili rezultonte i kualifikuar që në vlerësimin e datës 22.11.2019, me ofertë ekonomike më të ulët se operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues “Colombo” sh.p.k, nuk e ka ezauruar shkallën e parë të ankimit në përputhje

me parashikimet e nenit 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në lidhje me vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “2N” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Për këto arsye, KPP nuk mund të shqyrtojë pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për kualifikimin e operatorit ekonomik “2N” sh.p.k. për sa kohë që, ky ankim nuk është ezauruar, duke plotësuar kushtet formale, që në ankesën e parë të paraqitur pranë autoriteti kontraktor nga operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k., fakt për të cilin ky i fundit ishte në dijeni që në vlerësimin e datës 22.11.2019.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “6D - Plan” sh.p.k. & “2Z Konstruksion” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-34050-08-21-2019, me objekt: “Rikonstruksioni i tarracës së paraklinikut dhe bodrumeve të dekanatit të FM-së”, me fond limit 16.399.882 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Colombo” sh.p.k. për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1872 Protokolli
Datë 12.12.2019

Nr. 1939 Protokolli
Datë 26.12.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha